



FEDERATA ATLETIKE E KOSOVËS

RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN
E NUMRIT TË VOTAVE NË KUVEND

Prishtinë, Dhjetor 2022

Në bazë të nenit 35 të Statutit të Federatës Atletike të Kosovës, në seancën e datës 03.12.2022 Bordit i FAK-ut miraton këtë:

RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË VOTAVE NË KUVEND

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet e drejta e Anëtarëve të Federatës Atletike të Kosovës në numrin e përfaqësuesve të tyre në Kuvend me të drejtë vote.

Neni 2

Të drejtën për të qenë pjesëmarrës në kuvend e kanë të gjithë Anëtarët e regjistruar në Federatën Atletike të Kosovës me nga një delegat.

Neni 3

Të drejtën në 1 (një) votë e ka Anëtari i Federatës i cili në fund të kalendarit garues ka marrë pjesë në 4 garat e organizuara nga FAK-u me së paku 6 atlet të njëjtë (që përfundojnë garën).

Neni 4

Të drejtën në 2 (dy) vota e ka Anëtari i Federatës i cili në fund të kalendarit garues ka marrë pjesë në 4 garat e organizuara nga FAK-u me së paku 8 atlet të njëjtë (që përfundojnë garën).

Neni 5

Votat e përcaktuara nga neni 3 dhe 4 nuk mblidhen.

Neni 6

Nëse klubi ndryshon emrin, ai mbetet pasardhësi ligjor i statusit që ka pas emrin e vjetër.

Neni 7

Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë ditë pas datës së publikimit në faqen zyrtare të Federatës.

Prishtinë, më
03.11.2022

Kryetari i FAK-ut
Halil Sylejmani

